



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës:	2022:226589
Datë:	12.05.2023
Numri i dokumentit:	04273311
Dosja fizike:	C-IV-15-1199

Rr M Fshati Sh, Komuna e Obiliqit.  
I përfaqësuar sipas autorizimit nga G A, avokat nga Prishtina

*Paditësi*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 12.05.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Për shkak të mosbindjes**

I. Miratohet si bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr M dhe NDRYSHOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PRN173-0385, i datës 25.05.2015, ashtu që vendoset si në vijim:

Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 655.39 €, në emër të kompensimit të pagave të papaguara përgjatë periudhës 14.02.2007-15.06.2011, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 78.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

**Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 25.06.2015, paditësi ka paraqitur padi pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i

Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN173-0385 dhe të detyrohet pala e paditur që t'ia kompensoj pagat e pa paguara për periudhën 14.02.2007-15.06.2011. Në padi ndër të tjera është theksuar: paditësi ka qenë në marrëdhënie punë në “New Co Grand Hotel”, sh.p.k, dhe këtë fakt e dëshmojnë dy provat e dorëzuara - kontratat e punës. NSH-ja është privatizuar me Special dhe se vazhdimisht ka qenë nën mbikëqyrjen e AKP-së. Ndërmarrja ka paguar pagat por ka mbetur mbrapa me pagesa ndaj paditësit në shumën prej 655.39 €. Paditësi dhe punëtorët e tjerë kanë paraqitur kërkesa në AKP për kompensimin e pagave mirëpo zëvendësdrojtresha e AKP-së M T në letrën e saj drejtuar punëtorëve ka theksuar se të gjitha kërkesat e punëtorëve do të shqyrtohen në procedurë të rregullt nga Autoriteti i Likuidimit dhe se deri atëherë duhet të presin. Më tutje, në padi është theksuar se kërkesa kreditore është paraqitur me datën 18.03.2015, respektivisht brenda afatit ligjor. Me padi i është propozuar gjykatës që kërkesëpadi të aprovet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 655.39 €, në emër të kompensimit të pagave për periudhën 14.02.2007-15.06.2011. Padi i është bashkëngjitur vendimi i atakuar i AL-së, PRN173-0385, i datës 25.05.2015.

Me urdhrin e datës 11.10.2022, Dhoma e Posaçme e ka ftuar të paditurën që të paraqes përgjigje në padi. Nga dëshmia e dorëzimit që gjendet në shkresat e lëndës, shihet se urdhri i është dorëzuar të paditurës më 13.10.2022. Megjithatë, gjykatës nuk i është dorëzuar përgjigja në padi.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës që të ushtroj mjetin juridik – ankesën, kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin dhe ndryshimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.

- Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritore pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore dhe as veprime të mëtejshme procedurale e kemi të rregulluar me nenin 150.1 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

*Në çoftë se i padituri brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimin për shkak të mos bindjes), po që se janë plotësuar këto kushte:*

- a) *Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,*
- b) *Po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi; dhe*
- c) *Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.*

Padisë i janë bashkëngjitur provat si në vijim: Kontrata e Punës, nr.224, dt. 03.01.2007; Kontrata e Punës, nr. 224, dt. 03.04.2007; Lista e pagave të papaguara, e dt. 11.11.2014; Aktvendimi nr. 87, dt. 16.03.2012; Shkresa e AKP-së, e datës 07.08.2012; vendimi i dt. 02.04.2012, Vendimi i dt. 24.04.2012; Kërkesa e dt. 09.10.2014; dhe njoftimi i AKP-së drejtuar paditësit i datës 02.02.2015, mbi njoftimin e likuidimit të ndërmarrjes dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Nga të dhënat në shkresat e lëndës dhe provat e parashtruara, gjykata konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes. Të paditurës i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në padi, brenda afatit të paraparë me ligj. Nga shqyrtimi i fakteve të paraqitura në padi dhe vlerësimi i provave të bashkëngjitura me padinë, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykata e ka bërë shikimin dhe leximin e provave të lëndës dhe ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia nuk është në kundërshtim me provat që i ka propozuar paditësi dhe me faktet e ditura botërisht. Ndaj, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e nenit 150.1 të LPK-së për të marrë vendim për shkak të mosbindjes, gjë që është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet procedurale**

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar se “*Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t’i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë*”. Në këtë çështje kontestimore, pala paditëse ka

kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar ato. Gjykata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur paditësit të drejtën në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi i njëjti e ka fituar gjykimin, në shumën prej 78 €, në emër të përpilimit të padisë. Palës nuk është vendosur ndonjë detyrim lidhur me taksat gjyqësore, për shkak të vlerës së vogël të kontestit.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
**Mr.sc. Bajram Miftari**